

Ambasadorët për Perspektiva të Reja

Përshkrim i shkurtër i programit

Projekti Perspektiva të Reja lançon programin më të ri “Ambasadorët për Perspektiva të Reja”, për të rinjtë e moshës 14-18 vjeç nga qarku i Kukësit, të cilët duan të angazhohen si ambasadorë të “Perspektiva të Reja” në shkollën e mesme ku ata studiojnë, përgjatë vitit akademik.

Ky program ka si fokus të rinj të apasionuar pas aktivizimit dhe krijimit të ndryshimeve shoqërore, në veçanti të çështjeve që lidhen me ta. Programi “Ambasadorët për Perspektiva të Reja” kërkon të rinj ambasadorë që do të promovojnë dhe përfaqësojnë projektin në të gjithë Qarkun e Kukësit.

Programi synon të drejtojë fushata dhe aktivitete në lidhje me çështjet e të rinjve dhe jo vetëm, të cilat do të promovohen nga ata tek bashkëmoshatarët dhe në shkollat e tyre përkatëse. Ata do të jenë të përfshirë në organizimin e aktiviteteve që përfshijnë të rinjtë dhe nisma të tjera. Ambasadorët do të marrin trajnime për të rritur aftësitë e tyre gjatë gjithë mandatit.

Programi është një mundësi e shkëlqyer për çdo student të shkollës së mesme që dëshiron të mësojë, dhe kontribuojë në shoqëri në të njëjtën kohë.

Qëllimi i programit

Skema e ambasadorëve të rinj ndihmon nismat e projektit Perspektiva të Reja dhe zgjeron përfshirjen e komunitetit në aktivitete. Misioni i projektit Perspektiva të Reja është të investojë tek të rinjtë e rajonit që të shfaqin potencialin e tyre dhe të bëhen novatorët socialë për përmirësimin e komunitetit, qytetit, dhe rajoni në përgjithësi. Ambasadorët studentë janë të inkurajuar të marrin një rol aktiv për t adresuar problemet më shqetësuese për ta dhe të punojnë bashkë për të përmirësuar shkollat dhe komunitetin e tyre.

Përse duhet të jesh një ambasador për Perspektiva të Reja?

Ambasadorët do të kenë mundësinë:

- T’i bashkohen një rrjeti vullnetar të liderave të të rinjve nga i gjithë qarku.
- Të zhvillojnë aftësi thelbësore për jetën akademike dhe punësimin.
- Të pasurojnë jetën e tyre studentore.
- Të marrin pjesë në evente dhe aktivitete të projektit.
- Të përfitojnë nga sesionet e dialogut dhe trajnimeve me ekspertët.
- Mbështetje për të organizuar në mënyrë të pavarur rrjetin e tyre dhe fushatat.
- Një mundësi për të kuptuar dhe mësuar mbi projektet dhe organizatat nderkombëtare.
- Të jenë pjesë aktive e dizajnit dhe zhvillimit të aktiviteteve në shkolla.
- Marrja e një letre referencë zyrtare pas mbarimit të programit.

Cfarë do të bëjnë Ambasadorët e rinj ?

Amasadorët do të përfshihen në një shumëllojshmëri aktiviteteve, duke përfshirë:

- Përfshirja në sesionet e trajnimeve.
- Të qënurit pikë kontakti për shkollat dhe bashkëmoshatarët e tyre.
- Pjesëmarrja në promovimin e eventeve dhe nismave të projektit në platformat e mediave sociale.
- Organizimi i fushatave të komunikimit në komunitetet e tyre.

- Përfshirja në krijimin dhe zbatimin e fushatave të komunikimit të projektit.

Kohëzgjatja e programit

Të rinjtë që do të bashkohen programit “Ambasadorët për Perspektiva të Reja”, do të angazhohen për një periudhë 9-mujore, të bazuar në shkollat e tyre përkatëse. Ky program do të ndjekë skemën e rotacionit, duke ofruar hapësirën për shumë të rinj të përfshihen në projekt. Kështu, pasi raundi i parë i programit të ketë përfunduar, projekti do të hapë sërish një thirrje për të rekrutuar të rinj të tjerë, me disa runde gjatë gjithë periudhës 3-vjecare të zbatimit të projektit.

Shpërblimi

Pjesëmarrja në programin e Ambasadorëve të rinj është vullnetare, megjithatë, kostot që lidhen me aktivitetet mbulohen nga projekti dhe subvencione mund të aplikohen rast pas rasti.

Menyra e aplikimit

Aplikantëve u kërkohet të dërgojnë me email sa vijon:

1. Letër motivimi e cila duhet të përfshijë:

- informacion për aplikantin dhe angazhimin e tyre aktual në shkollë
- motivimi për t'u bërë pjesë e programit të Ambasadorëve
- ide se si aplikantët mund të kontribuojnë në komunitetet e tyre nëpërmjet këtij angazhimi
- angazhimi i mëparshëm në iniciativat e komunitetit dhe rinisë (nëse ka)

Aplikimi duhet dërguar në adresën e email-it: info.np@swisscontact.org